

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087¹, nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike², në bazë të akteve të brendshme të ndërmarrjes dhe akteve tjera pozitive relevante, Bordi i Drejtorëve i NPL “Stacioni i Autobusëve”, Sh.A, Podujevë, në mbledhjen e mbajtur më datë: 10.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Ri-shpallet/Përsëritet Konkursi për Kryeshef Ekzekutiv të NPL “Stacioni i Autobusëve”, Sh.A, Podujevë, nr. 31 dt. 13.01.2021
- II. Konkursi do jetë i hapur nga data 11.03.2021 deri me datën 26.03.2021.

A r s y e t i m

Me datën 13.01.2021, Bordi i Drejtorëve të NPL “Stacioni i Autobusëve”, Sh.A, Podujevë, vendosi që konform normave në fuqi, të filloi plotësimin e strukturës organizative në Ndërmarrje, respektivisht pozitës vakante të Kryeshefit Ekzekutiv të paraparë me nenin 21 par. 21.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 31 / 15 QERSHOR 2008) dhe konform nenit 21 par. 21.1. Konkursi ishte shpallur për afat 15 ditor, duke filluar nga data 14.01.2021 deri me datën 28.01.2021.

Në mbledhjen e datës 29.01.2021, Bordi i Drejtorëve konform kompetencave të veta, mori vendim që të zgjasë afatin e konkursit, duke konstatuar se arkiva nuk ka pranuar asnjë aplikacion deri me atë datë. Konkursi u zgjat edhe për një afat tjetër, respektivisht deri me datën 16.02.2021.

Pas kësaj, Bordi u mbledh për trajtim të gjendjes ku u konstatua se arkiva ka pranuar vetëm dy (2) aplikacione, numër ky i pa-mjaftueshëm për realizim të një konkursi. Rrjedhimisht, Bordi mori vendim që të ri-shpallë/përsëris Konkursin për Kryeshef Ekzekutiv dhe atë nga data 11.03.2021 deri me datën 26.03.2021.

Konform Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe normave tjera në fuqi, Bordi i Drejtorëve do të kryejë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese me qëllim që emërimi të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës.


Bordi i Drejtorëve

Qëndresa Hyseni- Kryesuese

Nexhat Kastrati- Antar Bordi

Fatos Bahtiri- Antar Bordi

Arbër Beqiri- Antar Bordi



¹(GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III/Nr. 31/15 QERSHOR 2008)

²(GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS” NR. 13/30 MAJ 2012)